

V E N D I M
Nr. 429, datë 25.3.1996

PËR KOHËN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË SISTEMIN E SHËNDETËSISË
(Ndryshuar me VKM nr. 114, datë 31.3.2002)

(i përditësuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodin i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në sistemin e shëndetësisë kohëzgjatja maksimale javore e punës është 48 orë.
2. Pushimi ditor zgjat 12 orë pa ndërprerje dhe përfshin intervalin ndërmjet orës 2200 dhe 600. Personeli i zënë në punë para orës 600 ose pas orës 2200 do të ketë një pushim ditor të paktën 12 orë pa ndërprerje. Në rastin e mjekut të rojës dhe të urgjencës mjekësore do të zbatohen rregullat e përcaktuara në udhëzime të veçanta të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit.
3. Orari i punës në sistemin e shëndetësisë është nga ora 0000 deri në orën 2400. Turnet e punës janë turni i parë nga ora 600 deri në orën 1400, turni i dytë 1400 deri në orën 2200 dhe turni i tretë 2200 deri në 600.
4. Çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në orën 22.00 paguhet sipas rregullave të parashikuara në nenin 81 të ligjit nr. 7961, datë 2.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.
5. Pushimi javor është një ditë e javës, sipas marrëveshjes me punëdhënësin. Ky pushim duhet të jetë ditën e diel të paktën 1 herë në 4 javë.
6. Puna e kryer ditën e dielë ose në ditët e festave zyrtare kompensohet me një shtesë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 87 të ligjit nr. 7961, datë 2.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.
7. Për orët suplementare të punës, që nuk janë kompensuar me pushim, punëmarrësit i jepet paga normale dhe një shtesë mbi pagë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 91 të ligjit nr. 7961, datë 2.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.
8. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit nxjerr udhëzimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi